



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 990 / Prot.

Vlorë, më 23.04.2024

VENDIM
Nr. 19 datë 23.04.2024

PËR
NJË SAKTËSIM NË NENIN 3 TË RREGULLORES SË ZGJEDHJEVE PËR
AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORE

Në mbështetje të nenit 38, nenit 131, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19 pika 1, gërma dh) të Statutit të Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Urdhërit të MAS nr. 101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Urdhërit të Rektorit nr.48, datë 19.03.2024, si dhe në zbatim të shkresës nr.981 prot, datë 22.04.2024 të Sektorit Juridik, Senati Akademik në mbledhjen e dates 23.04.2024

VENDOSI:

1. Saktësimin e nenit 3 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:

Ishte:

Neni 3
Subjekti i rregullores

1. Subjekti i kësaj rregulloreje është Universiteti i Vlorës .
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kontratë me afat të pacaktuar me angazhim me kohë të plotë i njësive kryesore në Universitetin e Vlorës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur anëtari i personelit akademik i punësuar gjatë muajit të procesit zgjedhor.
3. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
4. Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitetin e Vlorës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë rregullore.

Bëhet:

Neni 3
Subjekti i rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje është Universiteti i Vlorës .
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njësive kryesore në Universitetin e Vlorës ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë rregullore. Nuk e gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur anëtari i personelit akademik i punësuar gjatë muajit të procesit zgjedhor.
3. Anëtarët e personelit akademik që, sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen si autoritete drejtuese ose në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
4. Çdo student i ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitetin e Vlorës ka të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik.
5. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë rregullore.

2. Të hiqet tog fjalëshi **personel akademik me kontratë me afat të pacaktuar me kohë të plotë** në pjesën e neneve që flitet për trupën zgjedhore në nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16 si dhe për pjesën e vëzhguesve në nenet 7, pika 7 dhe të lihet **personel akademik me kohë të plotë** sipas përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. Në nenin 25, pika 1, Dokumentacioni për kandidim, të hiqet *v. deklarin për neutralitetin politik, mosqenien pjese e forumeve te larta politike ne vend.* Në respektim kjo të Vendimit nr. 72, datë 30.04.2020 "Për shfuqizimin e pikës 13 të nenit 25 "Dokumentacioni për Kandidim" në rregulloren e organizimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë të Senatit Akademik.
4. Neni 25, pika 1, germa c te behet ndryshimi si me poshte:

Ishte: Formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:

Behet: Formularin e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) sipas aneksit 1 dhe 2 bashkëlidhur:

5. Rregullorja e saktësuar të përcillet në MAS dhe të publikohet në faqen web të UV-së.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

